

# TEKNOLOGJIA IoT PËR TOKAT BUJQËSORE

Mars 2021 | CSP



Dragino LSE01 është një sensor LoRa WAN që shërben për të matur lagështirën dhe cilësinë e ujit për tokat bujqësore. I aftë për të detektuar me precizion të lartë, ky sensor bën të mundur transmetimin e vlerave të matura nëpërmjet Wireless-it pa patur nevojën e përdorimit të kablllove. Ky sensor është krijuar për të matur lagështirën e tokës pavarësisht tipologjisë së saj.

Sensori i tokës përdor metodën FDR për të llogaritur lagështirën e tokës duke përdorur parametra si temperatura dhe konduktiviteti i tokës.

Teknologjia wireless LoRa e përdorur për këtë sensor lejon këtë të fundit të dërgojë të dhëna në distanca të gjata. Një karakteristë tjetër është imuniteti ndaj paisjeve të tjera wireless dhe minimizimi në maksimum i konsumit të baterisë.